

Jam shtatzënë. Përse duhet të vaksinohem?

Të dhënat që disponojmë tregojnë se në rast të infektimit me COVID-19, rrjedha e rëndë e sëmundjes tek nëna, rrit çënueshmërinë e grave shtatzëna e cila sjell rritjen e rrezikut të abortit dhe lindjes së parakohshme.

Kjo është arsyeja se përse Këshilli Superior i Sëmundjeve Infektive në Luksemburg (CSMI) rekomandon vaksinimin për gratë shtatzëna nga java e 10 -të e amenorresë.

Ky rekomandim aktualisht për momentin është i zbatueshëm vetëm për vaksinat e tipit mRNA.

Për të mbrojtur shëndetin tim dhe atë të fëmijës tim pas vaksinimit.

Ne duam që t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë shëndetit dhe fëmijës tuaj të palindur. Për këtë arsye ju do të kontaktoheni nga Qendra e Farmakovigilencës Nancy në fund të shtatzënisë tuaj në mënyrë që të kontrolloni gjendjen tuaj shëndetësore dhe atë të fëmijës tuaj. **Duam t'ju kujtojmë se deri më sot nuk është regjistruar asnjë rrezik.**

Çfarë duhet të bëj pasi të vaksinohem ?

- › Imuniteti zhvillohet brënda javëve të para pasi që është bërë vaksinimi i plotë. Prandaj ju nuk jeni në mbrojtje të menjëhershme!
- › Ekziston mundësia që ju ende mund të transmetoni COVID-19 tek ata përreth jush. Vazhdoni të respektoni rregullat mbrojtëse.
- › Në varësi të vaksinës që ju është aplikuar, mund të nevojiten dy doza: sigurohuni që të merrni një takim për dozën e dytë në qendrën e vaksinimit. Koha është e rëndësishme për të siguruar një shkallë të lartë të efikasitetit të vaksinës.
- › Vazhdoni të merrni pjesë në Testimin e Shkallës të Gjerë, edhe pse tashmë jeni vaksinuar.



Çfarë duhet të bëj në rast të efekteve anësore?

- › Vaksinat ashtu siç të gjitha ilaçet e tjera, mund të japin efekte anësore.
- › Efektet anësore me tepër të raportuara janë: dhimbje në vendin e injeksionit, lodhje, dhimbje koke, dhimbje trupi, të dridhura, dhimbje të kyçeve dhe temperaturë. **Këto efekte janë të padëshirueshme, por ato zhduken vetë pas disa ditësh dhe për këtë arsye nuk janë serioze.**
- › Ekziston mundësia që disa efekte anësore të jenë më intensive dhe të zgjasin më shumë ose të shfaqen pas një periudhe më të gjatë pas vaksinimit. Ato gjithashtu mund të jenë të një lloji më të ndryshëm dhe të rrallë: Efektet të cilat nuk dihen në kohën kur vaksina vihet në dispozicion, quhen efekte të papritura. **Është e rëndësishme që ju të na raportoni këto efekte serioze ose të papritura në mënyrë që ne të veprojmë në përputhje me rrethanat.**
- › Në rast se keni ndonjë efekt anësor, **flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.** Ju gjithashtu mund t'i deklaroni ato drejtpërdrejt nëpërmjet sistemit të deklarimit kombëtar: <https://gd.lu/8n3FhB>
- › Broshura për vaksinën mund ta gjeni në **covidvaccination.lu** brënda seksionit **InfoVAXX.**

